



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

EKSTRAKT

Nga procesverbali i mbledhjes së 39-të të Komitetit për Komunitete të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 16.06.2025, në sallën numër 2 kati i 3-të, në ora 13,⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Skender Bikliqi, kryesues
2. Gentianë Hoxhaj, anëtare
3. Shahadije Bikliqi-Dragaçina, anëtare
4. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
5. Enver Kryeziu, anëtar
6. Zoran Cirkovic, anëtar
7. Slavisa Trajkovic, anëtar
8. Olga Gucic, anëtare
9. Idajet Garip, anëtar

Të tjerë prezent

1. Visar Kozhani, zyrtar i lart i buxhetit
2. Përfaqësues të OSBE-së
3. Naser Bytyqi, përkthyes shqip-serbisht

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**

Kryesuesi i Komitetit Skender Bikliqi, pasi i përshëndeti të pranishmit, tha se rendin e ditës e keni marrë me kohë dhe e lexoi në vazhdim:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e 38-të
2. Informatë, nga drejtorati për buxhet, rreth Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028, në veçanti për vendet ku jetojnë komunitetet jo shumicë.
3. Raporti i punës së ZKKK-së
4. Të ndryshme

I

Aprovimi i Ekstraktit nga mbledhja 38-të e Komitetit për Komunitete

Lidhur me këtë pikë, kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi, pyeti anëtarët e Komitetit, se a ka dikush vërejtje, apo plotësime të ekstraktit nga mbledhja 38-të e Komitetit për Komunitete?

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit, konstatoi se Komiteti unanimisht aprovoi të njëjtin.

II

Informatë, nga drejtorati për buxhet, rreth Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028, në veçanti për vendet ku jetojnë komunitetet jo shumicë.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi, ia kaloi fjalën Visar Kozhanit, zyrtar kryesor financiar i cili i njoftoi në pika të shkurtra rreth Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028, në veçanti për vendet ku jetojnë komunitetet jo shumicë.

Pastaj kryesuesi hapi diskutimin.

Skender Bikliqi, tha se unë kam disa çështje për ti ngritur rreth Janjeves, e para ka problem me ujë të pijes që një kohë të gjatë, e dyta po ashtu ndriçimi publik nuk është funksional po thuaj në shumicën e Janjeves po ashtu ka edhe probleme të tjera. Duhet me i paraparë në buxhet disa investime për Janjevë pasi që po ka kërkesa të shumta nga qytetarët.

Shahadije Dragaçina, tha se Janjeva sa i përket investimeve është në gjendje jo të mirë, ka mungesë të ujit të pijes që disa vite, po ashtu mungon ndriçimi publik, ka probleme të tjera që po përballen qytetarët. Po ashtu tha se në emër të komitetit për komunitete kemi bërë një kërkesë dhe po e dërgojmë te drejtoria për buxhet në mënyre që të përfshihen disa investime në Janjevë.

Olga Gucic tha edhe unë pajtohem me parafolësët që në Janjevë nuk po punohet ka mungesë të ujit të pijes të ndriçimit publik. Po ashtu ka problem me qentë endacak dhe kohen e fundit edhe me gjarprinj.

Zoran Cirkovic, tha se a mundemi që ne si komitet me pas listën me projektet të cilat janë paraparë dhe pajtohem me kolegët parafolës.

Visar Kozhani, tha se sa i përket ndriçimit publik, është bërë një ankese dhe lënda është në OSHP. Ndërsa sa i përket listës ende nuk është përfundimtarë por kur të ua përcjellim për kuvend, ua përcjellim dhe juve si komitet.

Pasi diskutime tjera nuk pati u kalua në pikën në vazhdim.

III

Raporti i punës së ZKKK-së

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi, ia kaloi fjalën Lidia Jovanovic e cila i njoftoi në pika të shkurtra rreth Raportit të punës së ZKKK-së

Pastaj kryesuesi hapi diskutimin.

Zoran Cirkovic, tha se dua ta ngris një shqetësim të cilin e kam ngritur edhe më herët rreth një personi në Grackë i cili ka problem me dokumentacion e i cili kërkon që përmes zyrës për ndihmë juridike ti ndihmohet që të bëjë rregullimin e dokumentacionit për pronë dhe çështje tjera.

Lidija Jovanovic, tha se sa i përket atij personi ne kemi provuar disa herë mirëpo nuk mund të bëjmë asgjë pasi që nuk e ka pronën në emër të vetin dhe nuk mund të bëjmë asgjë.

Pasi diskutime tjera nuk pati u kalua në pikën në vazhdim.

Të ndryshme

Meqë çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 14²⁰.

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit

Skender Bikliqi